


REPUBLIKA E SHQIPERISE  
DHOMA E NOTEREVE TIRANE

Nr. 3203 Rep.

Nr. 812/11 Kol.



**KONTRATE SHITJE  
(PJESË KAPITALI)**

Sot ne daten 16. 10. 2019 (dymije e nëntëmbdhjete), u paraqiten personalisht para meje, notere Edlira HYSENI, me adrese ne Bulevardin "Zog I" ne katin e dyte te pallatit 12 katesh, palet kontraktuese si vijon :

**PALA SHITESE:**

1. **Edison SHEMA**, atesia Mustafa, shtetas shqiptar, i lindur më 29 Shtator 1975, në Elbasan dhe banues në Tiranë, rruga "Brigada VIII", P. 8, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar, i identifikuar nga karta e identitetit me nr. 034009497 dhe me nr personal H50929128F

*Këtu e në vijim Pala Shitëse.*

**PALA BLERESE:**

1. **Shoqëria Tregëtare "Adrenaline Investments" Shpk**, mbajtëse e Numrit Unik të Identifikimit / NUIS **L92216006U**, me seli në adresën: Tirane, Njesia nr.5, Komuna e Parisit, Rruga Osman Myderizi, Pallatet e Lures, Nr. 5, Nr. pasurie 6/475-N2.

Në këtë akt e përfaqësuar nga administratori, **Z. Edison SHEMA**, atesia Mustafa, shtetas shqiptar, i lindur më 29 Shtator 1975, në Elbasan dhe banues në Tiranë, rruga "Brigada VIII", P. 8, i identifikuar nga Letër Njoftimi ID me nr. 034009497 dhe me nr. personal H50929128F.

*Këtu e në vijim Pala Blerese.*

**IDENTIFIKIMI I PALËVE**

Unë noterja, nëpërmjet Ekstraktit të Gjendjes së Rregjistrimit, lëshuar nga QKR, verifikoj gjendjen e rregjistrimit të shoqërisë "**T.I.Shoes**" sh.p.k, dhe konstatoj se është shoqëri aktive. Z.Edison SHEMA, zotërues i pjesës së kapitalit në shitje më deklaroi personalisht se Shoqëria "T.I.Shoes" sh.p.k, është shoqëri aktive, nuk është në proces falimentimi, nuk është në ndjekje penale dhe se as shoqëria dhe as pjesa e kapitalit në shitje nuk është nën sekuestro apo nën forma të tjera të kufizimit dhe e lire per qarkullim civil te pjeseve te kapitalit.

Unë noterja, nëpërmjet Ekstraktit të Gjendjes së Rregjistrimit, lëshuar nga QKR, verifikoj gjendjen e rregjistrimit të shoqërisë "**Adrenaline Investments**" sh.p.k, dhe konstatoj se shoqëria është shoqëri aktive. Z.Edison SHEMA, në cilësinë e tij si administrator i shoqërisë më deklaroi personalisht se Shoqëria "Adrenaline Investments" sh.p.k, është shoqëri aktive, nuk është në proces falimentimi, nuk është në ndjekje penale, nuk është nën sekuestro apo nën forma të tjera të kufizimit të zotësisë së saj juridike dhe e lire per qarkullim civil te pjeseve te kapitalit te saj.

Individët, persona fizikë, pjesëmarrës ne akt dhe zotësinë e tyre e identifikoj nëpërmjet leternjoftimeve të paraqitur prej tyre dhe në prezencë. Adresat e shenuar ne hyrje te aktit raportohen personalisht prej tyre.

Personat si më sipër identifikuar, me vullnet të lirë dhe të plotë, me kërkesë të shprehur personalisht, të informuar e në dijeni të pasojave ligjore ne rast deklarimi te pavertete më kërkuan mua noteres të përpiloj këtë akt.

**BAZA LIGJORE:**

- 1- Ligji Nr. 9901, date 14.04.2008 "Per Tregëtarët dhe Shoqëritë Tregëtare",
- 2- Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë;

Personat sa më sipër, pasi deklarojne se kanë marrë konsulencën e nevojshme juridike dhe fiskale, me kërkuar bashkërisht dhe veç e veç te hartohet kjo Kontratë me kushtet dhe kriteret e mëposhtme:

**RRETHANA PARAPRAKE**

A. Shoqëria "T.I.Shoes" shpk është regjistruar si person juridik me përgjegjësi të kufizuar, e identifikuar me numer NIPT: L92112007F, me adrese: Tirane Tirane TIRANE Bulevardi Zog I-re, pallati Kirshberger, kati 2-te. Kapitali i shoqërisë është i ndarë në 4 (katër) Pjesë Kapitali zotëruar nga ortakeve si vijon:

- 1) **Edison SHEMA**, zotëron **1 (një) pjesë** në kapital me vlerë të përgjithshme ALL 85 000,00 (tetëdhjet e pesë mijë lekë) që përbën **85%** të kapitalit të shoqërisë.

- 2) **Fabrizio SALVATORI**, zotëron 1 (një) pjesë në kapital me vlerë të përgjithshme ALL 10 000,00 (dhjet mijë lekë) që përbën 10% të kapitalit të shoqërisë.
- 3) **Carlo LIPARI**, zotëron 1 (një) pjesë në kapital me vlerë të përgjithshme ALL 3 000,00 (tre mijë lekë) që përbën 3% të kapitalit themeltar të shoqërisë.
- 4) **Mirela GJONI**, zotëron 1 (një) pjesë në kapital me vlerë të përgjithshme ALL 2 000,00 (dy mijë lekë) që përbën 2% të kapitalit themeltar të shoqërisë.

**B.** Pala Blerese, Shoqëria tregëtare "Adrenaline Investments" shpk, është regjistruar si person juridik me përgjegjiesi te kufizuar, e identifikuar me numer NIPT: L92216006U.

**C.** Pala Blerese, Shoqëria tregëtare "Adrenaline Investments" shpk, me Vendimin e saj Nr T-1, datë 16.10.2019 ka vendosur blerjen nga **Edison SHEMA të 1 (një) pjesë** në kapital, që përbën **85%** të kapitalit të shoqërisë "T.I.Shoes" shpk, e zotëruar nga Pala Shitëse Edison SHEMA.

**D.** Shoqëria "T.I.Shoes" shpk në statutin e saj Neni 10. Paragrafi 10.4 përcakton se, citojmë: "*Autorizohet ortaku Edison Shema që pjesë, nga pjesa e vet në kapital, të ja kaloi njëshoqërie tregëtare të zotëruar dhe/ose të përzgjedhur prej tij. Ortakët Fabrizio SALVATORI, Carlo LIPARI dhe Mirela GJONI japin miratim të shprehur për kalim duke hequr dorë nga e drejta e parablerjes për kuotat e ortakut Edison Shema,*

Personat sa më sipër, pasi deklarojnë rrethanat paraprake si me sipër, me kerkuan bashkerisht dhe veç e veç te hartohet kjo Kontratë me kushtet dhe kriteret e mëposhtme:

#### **NENI 1**

##### **OBJEKTI I KONTRATËS**

Objekti i kësaj kontrate është:

- Shitja prej Pales Shitese, **Edison SHEMA** i pjeses se zotëruar prej tij ne shoqërinë "T.I.Shoes" shpk, pjesë e barabarte me **85%** të kapitalit të shoqërisë "T.I.Shoes" shpk.
- Blerja prej blerësit, **Shoqërisë Tregëtare "Adrenaline Investments" shpk** te pjeses qe **Edison SHEMA** shet, ose thene ndryshe të **85%** të kapitalit të shoqërisë "T.I.Shoes" shpk.

Pala Shitese, deklaron se me dëshirë të shprehur, me vullnet te lire e te plote i shet blerësit pjesen e saj ne kete shoqëri dhe blerësi deklaron se është plotësisht dakord me kete blerje.

#### **NENI 2**

##### **ÇMIMI I KONTRATËS**

Me marreveshje te perbashket te dy palet kane percaktuar se:

Çmimi total per shitblerjen e pjeses se zotëruar nga Edison SHEMA ose thene ndryshe Çmimi total per shitblerjen e **85%** te kapitalit të shoqërisë "T.I.Shoes" shpk është 85 000,00 (tetëdhjet e pesë mijë leke).

Çmimi total per shitblerjen është likuiduar tërësisht përpara nënshkrimit të kësaj kontrate.

Me nënshkrimin e kesaj kontrate noteriale, shitesi Edison SHEMA humbet çdo te drejte pronësie mbi pjesen e tij ne shoqërinë "T.I.Shoes" shpk dhe del nga ortakëria në shoqëri.

Me nënshkrimin e kesaj kontrate shitblerje, Shoqëria Tregëtare "Adrenaline Investments" shpk bëhet ortakë e re në shoqërinë "T.I.Shoes" shpk dhe zotëron (1) një pjesë të kapitalit dhe bëhet zotëruese e **85%** te kapitalit të shoqërisë "T.I.Shoes" sh.p.k. si vijon:

Ortak: Shoqëria Tregëtare "Adrenaline Investments" shpk

Numri i pjesëve:	1 (një);
Pjesëmarrja në përqindje:	85 %;
Me vlerë ALL:	85 000,00 (tetëdhjet e pesë mijë leke);

#### **NENI 3**

##### **GJËNDJA PRONËSORE PAS SHITBLERJES**

Me nënshkrimin e kësaj kontrate dhe regjistrimin e saj pranë QKB, Shoqëria "T.I.Shoes" sh.p.k. do të zotërohet nga ortakët si vijon:

- 1) **Shoqëria Tregëtare "Adrenaline Investments" shpk**, zotëron **1 (një) pjesë** në kapital me vlerë të përgjithshme ALL 85 000,00 (tetëdhjet e pesë mijë lekë) që përbën **85%** të kapitalit të shoqërisë.

- 2) **Fabrizio SALVATORI**, zotëron **1 (një) pjesë** në kapital me vlerë të përgjithshme ALL 10 000,00 (dhjet mijë lekë) që përbën **10%** të kapitalit të shoqërisë.
- 3) **Carlo LIPARI**, zotëron **1 (një) pjesë** në kapital me vlerë të përgjithshme ALL 3 000,00 (tre mijë lekë) që përbën **3%** të kapitalit themeltar të shoqërisë.
- 4) **Mirela GJONI**, zotëron **1 (një) pjesë** në kapital me vlerë të përgjithshme ALL 2 000,00 (dy mijë lekë) që përbën **2%** të kapitalit themeltar të shoqërisë.

#### NENI 4

#### DEPOZITIME TË PALEVE

Palët depozitojnë dhe kërkojnë që kontrates ti bashkëngjiten dhe të jene pjese integrale te saj edhe:

- Ekstrakt i Regjistrimit Tregetar te Shoqerise "T.I.Shoes" shpk;
- Ekstrakt i Regjistrimit Tregetar te Shoqerise "Adrenaline Investments " shpk;
- Vendimi i Asamblese i Shoqerise "Adrenaline Investments " shpk;
- Dokumentacioni i identifikimit te paleve.

Ky akt përpilohet ne katër kopje, kopjes se aktit që arshivohet ne zyrën time noteriale i bashkëngjiten imazhe të printuara nga imazhet e marra gjatë nënshkrimit.

Sa më sipër me kërkesë të shprehur të palëve përpilohet nga unë noteria kjo Kontratë shitjeje kuotash, e cila ju lexua palëve me zë.

Palët deklarojnë se e gjejnë tërësisht, e paragraf për paragraf në perputhje me vullnetin e tyre të lirë, të plotë e të pa vesuar, japin pëlqimin e tyre për gjithçka më sipër dhe e nënshkruan aktin rregullisht duke vendosur emer mbiemer dhe firmë.

Unë noteria e vertetoj përmbajtjen e aktit dhe nënshkrimin e palëve sipas ligjit.

PALA SHITESE  
Edison SHEMA

PALA BLERESE  
Shoqëria Tregëtare "Adrenaline Investments " shpk  
Administrator  
Edison SHEMA

*Edison SHEMA*  
*[Signature]*



Notere  
Edlira HYSANI

*Edlira HYSANI*  
*[Signature]*

